

Titulli i projektit:

**Përmirësimi i kërkimit shkencor me kërkuesit e rinj të
Departamentit të Gjuhës Angleze**



Grupi i punës:

Prof. Dr. Viktor Ristani - Udhëheqës i projektit

Prof. Dr. Elida Tabaku - Bashkëpunëtorë e projektit

Dr. Daniela Hasa - Bashkëpunëtorë e projektit

Dr. Etleva Kondi - Bashkëpunëtorë e projektit

Dr. Leonora Lumezi - Bashkëpunëtorë e projektit

Dr. Hatixhe Leka (Sejdini) - Bashkëpunëtorë e projektit

Msc. Brunilda Kondi - Bashkëpunëtorë e projektit

Msc. Sara Draçi - Kandidati Doktorant

Përmbledhja e Projektit:

Kërkimi shkencor dhe cilësia e tij janë në qendër të politikave arsimore dhe nismave që ndërmerren jo vetëm nga institucionet e arsimit të lartë por edhe nga agjenci apo organizata që synojnë të përmirësojnë fushën e tyre të aktiviteteve. Sipas Rregullores së Universitetit të Tiranës, misioni i tij lidhur me kërkimin shkencor është krijimi i njohjeve dhe zgjidhjeve të çështjeve të ndryshme për t'i ardhur në ndihmë nevojave të shoqërisë. Sipas planit

Nisur nga kjo analizë e situatës, projekti synon të njohë grupet e synuara dhe përfituesit me disa nga metodat, mjetet dhe mënyrat e pëpunimit të të dhënave në një kërkim shkencor, të ofrojë burime, qoftë materiale apo njerëzore duke përmbushur kërkesat aktuale, të sigurojë tema masteri më cilësore, të shkruara sipas modelit të një punimi shkencor dhe duke shmangur plagjiaturën, të rrisë numrin e pranimeve për botim të artikujve në revista shkencore sipas standarteve ndërkombëtare. Përmbysja e këtyre objektivave do të krijojë një kulturë edukative që siguron një udhëheqje dhe mbikëqyrje të mirë dhe më të përshtatshme në të dyja nivelet e studimit kështu që kërkuesit e rinj mund të punojnë dhe të ndiehen të mbështetur.

Më tej, projekti pritet të ketë një ndikim afatgjatë në gjenerimin e strategjive që rrisin outputin e kërkimit shkencor, në rritjen e cilësisë së kërkimit duke e njëjtësuar me nivelet e kërkimit shkencor të universiteteve të huaja, krijimin e marrëdhënieve të ndërsjellta me organet eprore dhe biznesin për sigurimin e vendeve të qëndrueshme të punës, kërkimin cilësor dhe në ofrimin e mekanizmave mbështetës për kërkuesit e rinj si promovimi, siguria dhe stabiliteti në një vend pune dhe marrjen e rezultateve praktike në ndihmë të nevojave reale.

